



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P. 739/2018**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.10.2018 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë “*Gentian Horiati*” P.F dhe “*Lulzim Hasballa*” P.F, nga procedura e prokurimit “*Kërkese për Propozim*” me Nr. REF-78963-07-11-2018, me objekt: “*Blerje materiale për lysterje dhe shërbetime të objekteve të qytetit (shkolla, kopshte, cerdhe, biblioteke etj)*”, me fond limit 833,250 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 23.07.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Librazhd.

**Ankimues:** “Muça” shpk  
Adresa: Autostrada “Tiranë - Durrës”, km 13, Picar Vorë.

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Librazhd.  
Adresa: Sheshi “Gjorg Golemi”, Librazhd.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë, 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, pretendimet e tij dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky operator ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 12.07.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Kërkese për Propozim” me Nr. REF-78963-07-11-2018, me objekt: “Blerje materiale për lyerje dhe shërbetime të objekteve të qytetit (shkolla, kopshte, cerdhe, biblioteke etj)”, me fond limit 833,250 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 23.07.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Librazhd a.

II.2. Referuar informacionit të autroitetit kontraktor me shkresën 4459 prot, datë 04.09.2018, protokolluar me tonën me nr 1441/2 prot, datë 07.09.2018, si dhe sitemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), rezulton se në datën 07.08.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sitemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “Avni Hysa”	Pa dokumentacion	skualifikuar
2. “Doalpaint”	Pa dokumentacion	skualifikuar
3. “HB-Group Construction”	Pa dokumentacion	skualifikuar
4. “Paera”	Pa ofertë	skualifikuar
5. “Deutschcolor”	436,620 lekë	skualifikuar
6. “Gentian Horieti”	678,560 lekë	skualifikuar
7. “Lulzim Hasballa”	750,000 lekë	kualifikuar
8. “Muça”	766,600 lekë	kualifikuar
9. “Hasballa”	800,000 lekë	kualifikuar

II.3. Në datën 07.08.2018, operatori ekonomik “Muça” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin e ofertave si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi:

II.3.1. Referuar informacionit të autroitetit kontraktor me shkresën 4459 prot, datë 04.09.2018, protokolluar me tonën me nr 1441/2 prot, datë 07.09.2018, rezulton se operatori ekonomik “Muça” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me nr 4160 prot, datë 09.08.2018 ku kundërshton vendimin e KVO-së lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik “Lulzim Hasballa” në këtë procedurë prokurimi.

II.3.2. Me shkresën Nr. 4160/1 prot, datë 14.08.2018 autoritetit kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues ku ka vendosur refuzimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Muça” shpk, nga autoriteti kontraktor.

II.4. Në datën 07.08.2018, operatori ekonomik “Gentian Horieti” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.4.1. Referuar informacionit të autroitetit kontraktor me shkresën 4459 prot, datë 04.09.2018, protokolluar me tonën me nr 1441/2 prot, datë 07.09.2018, rezulton se operatori ekonomik “Gentian Horieti” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me nr 4169 prot, datë 10.08.2018 ku kundërshton vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e tij nga procedura prokurimit sa më sipërcituar.

II.4.2. Me shkresën Nr. 4169/1 prot, datë 14.08.2018 autoritetit kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues ku ka vendosur pranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Gentian Horieti” shpk.

II.5. Referuar informacionit të autroitetit kontraktor me shkresën 4459 prot, datë 04.09.2018, protokolluar me tonën me nr 1441/2 prot, datë 07.09.2018, si dhe sitemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), rezulton se në datën 13.08.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sitemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e ri-vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1.	“Avni Hysa”	Pa dokumentacion	skualifikuar
2.	“Doalpaint”	Pa dokumentacion	skualifikuar
3.	“HB-Group Construction”	Pa dokumentacion	skualifikuar
4.	“Paera”	Pa ofertë	skualifikuar
5.	“Deutschcolor”	436,620 lekë	skualifikuar
6.	“Gentian Horieti”	678,560 lekë	kualifikuar
7.	“Lulzim Hasballa”	750,000 lekë	kualifikuar
8.	“Muça”	766,600 lekë	kualifikuar
9.	“Hasballa”	800,000 lekë	kualifikuar

II.6. Në datën 13.08.2018, operatori ekonomik “Muça” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin e ofertave si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi:

II.6.1. Në datën 15.08.2018, operatori ekonomik “Muça” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me nr 4231 prot, ku kundërshton vendimin e KVO-së lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomik “Gentian Horieti” dhe “Lulzim Hasballa” në këtë procedurë prokurimi në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë vijon:

*AK- Bashkia Librazhd, me date 23.07.2018, ka zhvilluar tenderin me objekt prokurimi: Blerje materiale per lyerje dhe sherbetime te objekteve te qytetit (shkolla, kopshte, cerdhe , biblioteke etj, dhe fond limit: 833 250 (teteqind e tredhete e tre mije e dyqind e pesedhete) leke pa tvsh. Shoqeria jone, ka marre pjese ne kete gare, duke paraqitur Oferten e saj te shoqeruar me te gjitha dokumentacionin e kerkuar nga AK ne DT. Me 07.08.2018, ora 14.35, nepermjet SPE, njoftohemi nga ana e AK per vendimin e KVO- se per klasifikimin e Ofertuesve pjesemarres, si me poshte:*

1.	“Avni Hysa”	Pa dokumentacion	skualifikuar
2.	“Doalpaint”	Pa dokumentacion	skualifikuar
3.	“HB-Group Construction”	Pa dokumentacion	skualifikuar
4.	“Paera”	Pa ofertë	skualifikuar
5.	“Deutschcolor”	436,620 lekë	skualifikuar
6.	“Gentian Horieti”	678,560 lekë	kualifikuar
7.	“Lulzim Hasballa”	750,000 lekë	kualifikuar
8.	“Muça”	766,600 lekë	kualifikuar
9.	“Hasballa”	800,000 lekë	kualifikuar

*Me date 08.08.2018, shoqeria “Muça” ka derguar ankese prane AK, ankese e cila eshte marre ne dorezim nga AK me date 10.08.2018 (sipas gjurmimit te objektit tek faqja zyrtare e postes Shqiptare-bashkelidhur), me ane te se-ciles kerkonte s'kualifikimin e OE- Lulzim Hasballa, me argumentat shoqeruese te saj.*

*Pa na kthyer pergjigje akoma per ankesen e pare, AK, me date 13.08.2018, ora 13.31, publikon nje klasifikim te ri si me poshte:*

1.	“Avni Hysa”	Pa dokumentacion	skualifikuar
2.	“Doalpaint”	Pa dokumentacion	skualifikuar
3.	“HB-Group Construction”	Pa dokumentacion	skualifikuar
4.	“Paera”	Pa ofertë	skualifikuar
5.	“Deutschcolor”	436,620 lekë	skualifikuar
6.	“Gentian Horieti”	678,560 lekë	kualifikuar
7.	“Lulzim Hasballa”	750,000 lekë	kualifikuar
8.	“Muça”	766,600 lekë	kualifikuar
9.	“Hasballa”	800,000 lekë	kualifikuar

Cuditerisht, shohim qe jo vetem nuk eshte s'kualifikuar OE- Lulzim Hasballa, por, eshte kualifikuar edhe OE “Gentian Horieti” i cili ne klasifikimin e pare rezultonte i s'kualifikuar. Ne keto kushte, duke qene ne rastin e nje klasifikimi te ri, OE, pjesemarrës kane te drejten e ankimit se pari prane AK, sepse eshte bere rivendosje ne afat per ankim prane AK. Ne mbeshetje te Ligjit dhe nisur nga interesi i ligjshem shoqerise tone ne kete procedure per te fituar kontraten, dhe duke qene se OE “Lulzim Hasballa” dhe OE “Gentian Horieti”, jane te vetmit OE te kualifikuar me cmim me te ulet se shoqeria jone, ne KUNDERSHTOJME kualifikimin e tyre per arsyet e meposhtme:

Persa i perket OE- “Gentian Horieti”, pretendojme se ka keto mangesi per te cilat duhet te ishte s'kualifikuar:

1- OE- “Gentian Horieti”, nuk ploteson piken 2.3.2 te kerkesavete vecanta per kualifikim. Mostrat e paraqitura nga ky OE, ne tender, nuk plotesojne standartet shtetore dhe ST te DT, si dhe nuk ka paraqitur mostra per te dy llojet e bojrave (Boje hidroplastike dhe Boje per lysterje fasade e jashtme hidroplastike ) te kerkuara ne DT, por ka paraqitur vetem per njerën prej tyre. Ne keto kushte KVO-ja, nuk e ka te mundur te percaktojë nese mostrat e paraqitura nga ana e OE- “Gentian Horieti”, jane apo jo ne perputhje me standartet shtetore dhe ST te DT. Rrjedhimisht, ky OE nuk permbush kete kerkese te DT.

2- OE “Gentian Horieti”, nuk ploteson piken 2.3.3 te kerkesavete vecanta per kualifikim. Ky OE, nuk ka paraqitur pronesine e njesise se tregtimit apo pronesine e qiradhenesit, sipas ligjit - Certifikaten e pronesise. Rrjedhimisht, ky OE nuk permbush kete kerkese te DT. Rrjedhimisht, ky OE nuk permbush kete kerkese te DT.

3- OE “Gentian Horieti”, nuk ploteson kerkesen per kualifikim, Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 1. 9), qe thote: i;. “Vertetimin qe konfirmon shlyerjen e te gjitha detyrimeve te maturuara te energjise elektrike te kontratave te energjise qe ka operatori ekonomik qe eshte i regjistruar ne Shqiperi.

Dokumenti i paraqitur nga OE- “Gentian Horieti”, ne plotesim te kesaj kerkese, nuk eshte sipas ligjit pasi nuk tregon shlyerjen e detyrimeve te maturate energjise elektrike per muajin Maj 2018. Rrjedhimisht, ky OE nuk permbush kete kerkese te DT.

4- OE – “Gentian Horieti”, eshte kualifikuar pas riklasifikimit te dyte bere nga ana e KVO-se, ne kete rast KVO-ja ka shkelur ligjin, sepse nuk mund te beje me inisjativen e vet, rivleresim te Ofertes se nje OE per ta kualifikuar pasi ishte i s'kualifikuar, nqs nuk eshte bere ankese nga ky OE Brenda afateve ligjore prane AK. Prandaj Kualifikimi i OE “Gentian Horieti”, eshte i gabuar.

Persa i perket OE- “Lulzim Hasballa”, pretendojme se ka keto mangesi per te cilat duhet te ishte s'kualifikuar:

Te dy OE te kualifikuar gabimisht nga ana e KVO-se, pjesemarrës me oferte ne kete procedure prokurimi: “Lulzim Hasballa” dhe “HASBALLA”, kane pronar te njejte dhe drejtues



(administrator) te njejte, i cili rezulton z. Lulzim Hasballa. Ky fakt vertetohet shume thjeshte, nga Ekstraktet e QKB- se ketyre dy OE, te nxjerre nga WEB-i. (bashkengjitur kopje nga ëeb).

Ne keto kushte, duke qene se keto dy OE zoterohen dhe drejtohen nga i njejti person, NUK MUND TE KONKUROJNE TE DYJA ME NJERA TJETREN NE NJE TENDER, sepse jane ne shkelje te hapur te Ligjeve ne fuqi, dhe te konkurences se ndershme ne nje procedure tenderimi.

Pra z. Lulzim Hasballa., ka tentuar te konkuroje me veten ne kete tender, dhe me e pakta qe duhet te penalizonte OE – “Lulzim Hasballa”, eshte dhenia e ofertes alternative, e cila nuk eshte kerkuar ne DT nga ana e AK, pra te dy ofertat e z. Lulzim Hasballa, duhet te ishin refuzuar nga ana e KVO-se.

KVO-ja perkatese me, kualifikimin e OE - Lulzim Hasballa, ka shkelur:

- parimet kryesore te LPP, nenin 1. ~) etj.....,
- nenin 54 te LPP (Alternativat), qe thote: 2. Autoriteti kontraktor, ne njoftimin e kontrates duhet te percaktojese nese i autorizon alternativat, ne te kunden, ato nuk lejohen.

Theksojme se ne asnje vend te DT, nuk autorizohen ofertat alternative.

- nenin 63 te VKM per RRPP, ku thuhet: “Operatoret ekonomike duhet te paraqesin vetem nje otette, me perjashtim te rasteve kur kerkohen oferta alternative”:
- Ligjin Nr 9121, date 28.07.2003 “Per Mbrojtjen e Konkurences” (marreveshjet e ndaluara).
- Udhезimin e Autoritetit te Konkurences “Per luftimin e marreveshjeve te ndaluara ne oferta ne Prokurimet Publike” (bashkelidhur fq.3,8,16,22,25,26)

Asnje ofertues nuk mund te marre pjese ne oferten e dikujt tjeter per te njejten kontrate, ne cfardo lloj kapaciteti. Pjesemarrja nga nje ofertues me shume se nje oferte, tek e tek ose me nje ofertues tjeter, do te rezultojne ne perjashtimin nga prcesi te te gjitha ofertave, ne te cilat eshte perfshire ofertuesi.

Bazuar ne c'ka argumentuam me lart, ne baze te LPP, OE- Lulzim Hasballa, minimalisht duhet te s'kualifikohet nga ana e AK, ne kete procedure prokurimi, duke marre masa ndaj pesonave pergjegjes te KVO-se se AK, dhe me tej AK, duhet t'i propozojte APP, perjashtimin e OE “Lulzim Hasballa” dhe OE “HASBALLA”, nga procedurat e prokurimit publik per nje periudhe te caktuar kohe.

2- OE “Lulzim Hasballa”, nuk ploteson piken 2.2.2 te kerkesave te vecanta per kualifikim. Ky OE person fizik, kuk ka paraqitur bilancet e viteve 2016 dhe 2017, sic kerkohet ne “te paraqitura prane autoriteteve perkatese dhe te konfirmuara nga ky autoritet, te firmosura dhe te vulosura” Rrjedhimisht, ky OE nuk permbush kete kerkese te DT.

3- OE “Lulzim Hasballa”, nuk ploteson piken 2.3.2 te kerkesave te vecanta per kualifikim. Ky OE, deri ne ditën dhe oren e hapjes se Ofertave, nuk ka paraqitur prane AK, mostrat e

kerkuara ne DT. Per kete, kerkoj qe nga shqyrtuesit e ankeses (dhe me tej nga ana e KPP-se), te hapen kamerat e sigurise se Bashkise Librazhd, per te vertetuar se: Perverc OE "Muça" qe ka paraqitur mostra - 2 kova boje (hidroplastike per brenda dhe hidroplastike per jashte) dhe OE Gentian Horieti qe ka paraqitur 1 kove boje, asnje OE tjeter nuk ka paraqitur mostra - 2 kova me boje hidroplastike, prane AK, nga data e shpalljes se tenderit deri ne oren e hapjes se Ofertave, (vetem nqs, i kane futur ne xhep kovat !!). Rrjedhimisht, ky OE nuk permbush kete kerkese te DT

4- OE "Lulzim Hasballa", nuk ploteson piken 2.3.3 te kerkesave te vecanta per kualifikim. Ky OE, nuk ka paraqitur pronesine e njesise se tregtimit apo pronesine e qiradhenesit, sipas ligjit Certifikaten e pronesise. Rrjedhimisht, ky OE nuk permbush kete kerkese te DT.

5- Nuk ploteson kerkesen per kualifikim, Kriteret e vecanta te kualifikimit, pika 1. 9), qe thote: "Vertetimin qe konfirmon shlyerjen e te gjitha detyrimeve te maturuara te energjise elektrike te kontratave te energjise qe ka operatori ekonomik qe eshte i regjistruar ne Shqiperi". Dokumenti i paraqitur nga OE- "Lulzim Hasballa", ne plotesim te kesaj kerkese, nuk eshte sipas ligjit pasi nuk tregon shlyerjen e detyrimeve te maturate energjise elektrike per muajin Maj 2018. Rrjedhimisht, ky OE nuk permbush kete kerkese te DT.

Pra, z. Kryetar i AK, vendimi i KVO- se, per pranimin e ofertave te OE "Lulzim Hasballa" dhe OE "Gentian Horieti", eshte i nxituar, i gabuar, dhe ne shkelje te LPP dhe VKM per RRPP, per mos me thene i paragjykuar, rrjellimisht, ky vendim duhet ndryshuar nga ana juaj.

Kujtojme anetaret e Komisionit te Shqyrtimit te Ankeses: Ne nenin 46, pika 1, te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriieret qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjestim me neiyren dhe petmeset e kontrates qe do te prokurohen dhe jodiskriminuese." Ndersa ne nenin 53 pika 3 te ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" te ndryshuar parashikohet se "Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje otette te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percekuiere ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit, pa rene ndesh me percekuiemei e nenit 54 te ketij ligji."

Pra nisur nga percaktimet ligjore, Operatoret ekonomike jane te detyruar te pergatisin ofertat, ne perputhje me kerkesate percaktuara ne dokumentat e tenderit, pasi ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumenta duhet te refuzohen si te papranueshme.

Pra, nisur nga sa me lart cituam, OE "Lulzim Hasballa" dhe OE- "Gentian Horieti", nuk kane arritur te pergatisin oferten e tyre ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dosjen e tenderit, dhe rrjellimisht oferta e tyre duhet te refuzohet nga ana e AK.

I nderuar z. Kryetar i AK, ne perfundim, te bindur ne pretendimet tona te bazuara ne Ligj dhe ne prova, ne baze te LPP, ne VKM per RRPP dhe ne DT, kerkojme nga ana juaj:

*Shfuqizimin e vendimit te KVO- se per kualifikimin e OE “Lulzim Hasballa” dhe OE- “Gentian Horieti”, duke i s'kualifikuar ata nga procedura e prokurimit prane AK- Bashkia Librazhd, me objekt: “Blerje materiale per lyerje dhe sherbetime te objekteve te qytetit (shkolla, kopshte, cerdhe, biblioteke etj”)*, zhvilluar me date 23.07.2018.

II.6.2. Me shkresën Nr. 4231/1 prot, datë 20.08.2018 autoritetit kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues ku ka vendosur refuzimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “*Muça*” shpk, nga autoriteti kontraktor.

II.6.3. Në datën 28.08.2018 operatori ekonomik ankimues “*Muça*” shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. 4459 prot., datë 04.09.2018, protokolluar me tonën me numër 1441/2 prot., datë 07.09.2018, me objekt “*Informacion*” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “*Muça*” shpk.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “*Muça*” sh.p.k. mbi kundërshtimin e vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “*Gentian Horieti*”, me arsyetimin se: “*OE- Gentian Horieti, nuk ploteson piken 2.3.2 te kerkesavete vecanta per kualifikim. Mostrat e paraqitura nga ky OE, ne tender, nuk plotesojne standartet shtetore dhe ST te DT, si dhe nuk ka paraqitur mostra per te dy llojet e bojrave (Boje hidroplastike dhe Boje per lyerje fasade e jashtme hidroplastike ) te kerkuara ne DT, por ka paraqitur vetem per njeren prej tyre. Ne keto kushte KVO-ja, nuk e ka te mundur te percaktoje nese mostrat e paraqitura nga ana e OE- “Gentian Horieti”, jane apo jo ne perputhje me standartet shtetore dhe ST te DT. Rrjedhimisht, ky OE nuk permbush kete kerkese te DT.*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në Shtojcën 8/2, “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, pika 2.3.2 “*Kapaciteti teknik*”, të dokumentave të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, është kërkuar nga autoriteti kontraktor si më poshtë vijon

2.3.2. *Operatori ekonomik deri datën e zhvillimit të tenderit duhet të paraqesë prane zyrës së protokollit të Bashkisë Librazhd nga 1 (një) mostër të artikujve bojë hidroplastike sipas preventivit të publikuar në app.gov.al. Dorëzimi i mostrave nga ana e operatorit ekonomik do*



të shoqërohet me vërtetim të lëshuar nga Bashkia Librazhd mbi dorëzimin e mostrave. Për operatorët të cilët nuk do të rezultojnë të suksesshëm për këtë procedurë prokurimi mostrat do të kthehet brënda 30 ditëve pas nënshkrimit të kontratës.

III.1.2. Ndërsa në shtojcën 9, “Specifikimet teknike”, në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Materialet duhet të jenë të një cilësie të mirë sipas standarteve të lejuara dhe të shoqëruar me dokumentacion teknik.

1-Boja hidroplastike që do përdoret duhet të jetë e shoqëruar me etiketën përkatëse dhe brënda kushteve të standartit që është prodhuar.

2-Boja e vajit ti përgjigjet kushteve teknike dhe standarteve të kërkuara .

3-Stukoja, kola, dhe fino të jenë brënda afatit të prodhimit të shoqëruar me dok. Përkatës dhe cilësorë.

4-Boja hidroplastike që do përdoret për fasadën e jashtme duhet të jetë e cilesisë së lartë me të gjitha elementet e kërkuara sipas analizës teknike që ajo përmban. Materialet të jenë të gjitha cilësisë së lartë dhe sipas standarteve të EU.

**Garancia**

Kontraktuesi mban përgjegjësi për kualitetin në bazë të parametrave të artikujve. Nëse do të konstatohen se artikujt nuk plotësojnë karakteristikat dhe parametrat teknike të përcaktuara me lartë, ai detyrohet të zëvendësojë sasinë e reklamuar dhe të furnizuar të artikujve.

Afati i lëvrimin të mallrave: 5 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

III.1.3. Nga verifikimi në Sistemin e Prokurimeve Elektronikë (SPE), konstatohet se operatori ekonomik “Gentian Horiet” sh.p.k., në përmbushje të kriterit të sa mësipërcituar ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Skedë teknike për bojë hidroplastike (për ambiente të brendshme)
- Skedë teknike për bojë hidroplastike (për ambiente të jashtme)
- Shtojcën 6 “Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike”.
- Deklaratë Garancie

III.1.4. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.1.5. Në nenin 27, “Kontratat e mallrave” pika 3 e VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.1.6. Ndërsa në nenin 27 pika 6, gërma “b” të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, “Kontratat e Mallrave” parashikohet shprehimisht se: “Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit”. (b) “dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike”.

III.1.7. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

III.1.8. Komisioni sqaron se autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale të përcaktuara në dokumentat e tenderit, të tilla si mostra të mallit apo kataloge teknike kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike sikundër është kërkuar në këtë procedurë prokurimi. Nisur nga sa mësipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes se operatori ekonomik “Gentian Horieti” nuk i ka dorëzuar të gjitha mostrat sipas preventivit dhe konkretisht për artikullin Bojë hidroplastike (për ambiente të brëndshme) dhe Bojë hidroplastike (për ambiente të jashtme), nuk qëndron, pasi referuar informacionit të autoritetit kontraktor të depozituar pranë K.P.P, me shkresën nr. 4459 prot,

datë 04.09.2018, protokolluar me tonin me shkresën nr 1441/2 prot, datë 07.09.2018, vëren se autoriteti kontraktor nëpërmjetë vërtetimit me nr 3751 prot, datë 23.07.2018, vërteton se operatori ekonomik “Gentian Horiet”, ka dorëzuar mostrat sipas kërkesës së vetë subjektit sipas preventivit për objektin e prokurimit “Blerje materiale për lyerje dhe shërbetime të objekteve të qytetit (shkolla, kopshte, cerdhe, biblioteke etj)”. Fakti se nga ana e autoritetit kontraktor nuk mohohet ky fakt por vërtetohet nëpërmjetë vërtetimit nr 3751 prot, datë 23.07.2018 të paraqitjes së mostrave tw operatori ekonomik “Gentian Horiet”, ka paraqitur mostrat sipas preventivit, arrihet të vërtetohet që ky operator ekonomik plotëson kriteret e kërkuara nga autoriteti kontraktor, për paraqitjen e mostrave të cilat referuar edhe legjislacionit në fuqi- i shërbejnë autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar nga autoriteti kontraktor, si dhe kanë rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike sikundër është kërkuar në këtë procedurë prokurim nga vetë autoriteti kontraktor, si dhe vërtetuar po nga ky i fundit se operatori ekonomik “Gentian Horiet”, ka paraqitur mostrat sipas preventivit në dokumentat standarte të tenderit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Muça” shpk nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Muça” shpk mbi kundërshtimin e vendimit të KVO-së për kualifikimin operatorit ekonomik “Gentian Horiet”, me arsyetimin se “OE “Gentian Horiet”, nuk plotëson pikën 2.3.3 të kërkesave vecanta për kualifikim. Ky OE, nuk ka paraqitur pronësinë e njesise se tregtimit apo pronësinë e qiradhenesit, sipas ligjit - Certifikaten e pronësisë. Rrjedhimisht, ky OE nuk përmbush këte kerkese të DT. Rrjedhimisht, ky OE nuk përmbush këte kerkese të DT.”; Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.2.1. Në Shtojcën 8/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.3, “Kapaciteti teknik” të dokumentave të tenderit, rezulton se nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

2.3.3. “Operatori ekonomik duhet të disponoje ne pronesi ose me qera njesi tregtare ne territorin ku ushtron aktivitetin sipas ekstraktit te QKB-se. Per te deshmuar këte operatori ekonomik duhet te paraqese aktin e pronësisë ose ne rast qeraje duhet te paraqese kontraten me qiradhenesin si dhe aktin e pronësisë se tij”.

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike për operatorin ekonomik “Gentian Horiet”, në përmbushje të kriterit sa më sipër ky i fundit ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Ekstrakt historik të rregjistrimit tregtarë (QKB).
- Kontratë Huapërdorimi me Nr 7921 Rep dhe Nr 4093 Kol, datë 09.10.2015.
- Certifikatë Pronësie me Nr 849892

III.2.3. Në nenin 46, pika 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

III.2.4. Në nenin 53, pika 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.2.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Operatori ekonomik “Gentian Horiet”, në përmbushje të kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, ka paraqitur dokumentacionin përkatës në lidhje me disponueshmërinë e njësisë tregtare në territorin ku ushtron aktivitetin sipas ekstraktit të QKB për realizimin e kontratës.

Konkretisht, referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues “Muça” shpk se operatori ekonomik “Gentian Horiet”, nuk vërteton disponueshmërinë e njësisë tregtare në pronësi apo me qera, konstatohet se, operatori ekonomik “Gentian Horiet” në përmbushje të kriterit të më sipërcituar lidhur me vërtetimin e disponimit të një “njësie tregtare në territorin ku ushtron aktivitetin sipas ekstraktit të QKB-së”, ka paraqitur Kontratë Huapërdorie me Nr 7921 Rep dhe Nr 4093 Kol, datë 09.10.2015, lidhur pranë noterit publik me afat deri më 08.10.2015, ku përcaktohet dhe destinacioni i përdorimit të ambientit ku 22 m2 do të përdoren si njësi tregtare, dhe 77 m2 do të përdoren si magazinë, bashkangjitur kontratës së huapërdories ka paraqitur edhe aktin e pronësisë, dokumentacion ky i ngarkuar edhe në sistemin e prokurimeve elektronike, sipas kriteve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

III.2.7. Referuar kriterit të kualifikimit ku rezulton se autoriteti kontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomikë të provojnë se disponojnë në pronësi ose me qera një njësi tregtare në territorin ku ushtron aktivitetin sipas ekstraktit të QKB-së, duke paraqitur aktin e pronësisë ose në rast qeraje kontratën me qiradhënesin si dhe aktin e pronësisë së tij. KPP gjykon se operatori ekonomik “Gentian Horiet” me anë të dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të

prokurimeve (SPE), plotëson kriteret e kualifikimit të sipërcituara. Konkretisht operatori ekonomik “Gentian Horieti” shpk ka dorëzuar Kontratë Huapërdorie me Nr 7921 Rep dhe Nr 4093 Kol, datë 09.10.2015, lidhur pranë noterit publik me anë të së cilës dëshmon se disponon në një nga format e kërkuara edhe nga autoriteti kontraktor të njësisë tregtare në vëndin ku ushtron aktivitetin ky operator sipas ekstraktit të QKB-së, për realizimin me sukses të kontratës.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Muça” shpk nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Muça” shpk mbi kundërshtimin e vendimit të KVO-së për kualifikimin operatorit ekonomik “Gentian Horieti”, me arsyetimin se “OE “Gentian Horieti”, nuk plotëson kërkesën për kualifikim, Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 1. 9), që thote: i; “Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Dokumenti i paraqitur nga OE- “Gentian Horieti”, në plotësim të kësaj kerkese, nuk është sipas ligjit pasi nuk tregon shlyerjen e detyrimeve të maturate energjisë elektrike për muajin Maj 2018. Rrjedhimisht, ky OE nuk përmbush këto kerkese të DT.”; Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.3.1. Në Shtojcën 8/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 1, gërma “ç”, të dokumentave të tenderit, rezulton se nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

*“Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri”..*

III.3.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike për operatorin ekonomik “Gentian Horieti”, në përmbushje të kriterit sa më sipër ky i fundit ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

“Vërtetim debie” nr. 5904 prot, datë 13.07.2018, lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a, në emër të kërkuarit “Gentian Horieti”, ku evidentohet që: Kërkuarisi “Gentian Horieti”, nga verifikimet e kryera në sistemin e faturimit për kontratën/kontratën me kod: TR 2D050026068869; titullar dhe përdorues i të cilave është “Gentian Horieti”, rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 12.07.2018, pa përfshirë faturën koherente të muajit Qershor 2018”.

III.3.3. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Ndërsa neni 53, pika 3 përcakton: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe



*specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”*

III.3.4. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27, pika 5, gërma “c”, përcaktohet se: “Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: “c) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik”.

III.3.5. Në nenin 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me 5 Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.

III.3.6. Referuar korrespondencës zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh.a., këtu e në vijim ( OSHEE Sh.a), në datën 15.06.2015, është protokolluar shkresa e OSHEE-së me nr. 1081/1 prot., me objekt: “Kthim përgjigje kërkesës për informacion”, drejtuar Komisionit të i Prokurimit Publik, në të cilin jepet informacioni si më poshtë:

“[...] Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektike lëshon vërtetimet e debisë, bazuar në deklaratimet vullnetare të subjekteve kërkues të kontratave të energjisë elektrike. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektike evidenton saktësinë e dokumentacionit të paraqitur si më poshtë:

1. Tërësinë e kontratave të deklaruara nga subjekti (në rast se mund të ketë kontrata të tjera të padeklaruara).
2. Kontratat e furnizimit për objektet e tyre, duhet të jenë të tarifuara si private.
3. Kontratat e furnizimit duhet të jenë në emër të subjektit, përveç rasteve kur ato janë ambiente të marra me qira.

Në rast se subjekti ka paraqitur kontrata familiare, Operatori i kërkon këtij të fundit ndryshimin e tarifimit dhe pagesën me faturën e ardhshme të diferencës së cmimit bazuar në legjislacionin në fuqi dhe kontratën e furnizimit me energji elektrike. Të gjithë operatorët që kërkojnë të pajisen me Vërtetimin e Debisë duhet të aplikojnë pranë Qendrave të KNK në të gjithë Shqipërinë dhe lëshimi do të jetë i mundur jo më vonë se pesë ditë pas kërkesës nga subjekti. Mosplotësimi i kriterëve të 6 mësipëme do të rezultojë me moslëshimin e Vërtetimit të Debisë nga Drejtoria Qëndrore ose Drejtoritë Rajonale. Modeli zyrtar i lëshimit të Vërtetimit

të Debisë në të gjitha rastet e statusit të Operatorëve përmbledh informacionin përkatës për rastet kur:

1. Konsumatori nuk rezulton debitor në Sistemin e Faturimit.
2. Konsumatori rezulton debitor.
3. Konsumatori rezulton debitor por ka lidhur një aktmarrëveshje për shlyerjen e detyrimeve me këste.
4. konsumatori rezulton debitor por është në proces ankimi dhe ankesa është në trajtim nga strukturat e OSHEE-së.
5. Konsumatori rezulton debitor por vlera është e ankimuar në gjykatë.[...]

III.3.7. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik “Gentian Horiet”, ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike një vërtetim, sipas formatit të miratuar, me anë të së cilës vërtetohet se subjekti “Gentian Horiet” nuk rezulton debitor për kontratën e sipërcituar, pa përfshirë muajin e fundit të maturuar referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe Vendimit të ERE nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”. KPP gjykon se institucioni i OSHEE-së menaxhon sistemin e të dhënave për pagimin e energjisë elektrike për të gjithë subjektet përdoruese të energjisë elektrike për të gjithë kontratat e lidhura midis OSHEE-së dhe subjekteve përdoruese të energjisë elektrike. Për sa kohë që operatori ekonomik “Gentian Horiet”, e ka dorëzuar vërtetimin e sipërcituar dhe aq më tepër që sipas vërtetimit të lëshuar nga OSHEE, ky operator nuk figuron debitor, atëherë rrjedhimisht kriteri i sipërcituar në dokumentat e tenderit është i përmbushur nga operatori ekonomik “Gentian Horiet”.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes “Muça” shpk nuk qëndron.

III.4. Sa i takon pretendimit të operatorit ekonomik ankimes se me riklasifikimin e datës 213.08.2018 janë shkelur një seri nenesh të Ligjit Për Prokurimin Publik dhe ligjeve të tjera, për trajtim të barabartë dhe mosdiskriminimin e ofertuesve, Komisioni gjykon se nuk qëndron, pasi referuar informacionit të autoritetit kontraktor të depozituar pranë K.P.P, me shkresën nr. 4459 prot, datë 04.09.2018, protokolluar me tonin me shkresën nr 1441/2 prot, datë 07.09.2018, vëren se autoriteti kontraktor ka bërë rivlerësimin e ofertave pas procedurës së shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Gentian Horiet” me nr 4169 prot, datë 10.08.2018, i cili kundërshton vendimin e KVO-së të datës 07.08.2018 për skualifikimin e tij nga kjo procedurë prokurimi. Në informacionin e autoritetit kontraktor të depozituar pranë K.P.P, konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik “Gentian Horiet” ka vendosur pranimin e saj dhe pasqyrimin e veprimeve në sistemin elektronik të prokurimeve nëpërmjet rivlerësimit të procedurës në përputhje me lgjislacionin në fuqi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes “Muça” sh.p.k nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Muça” sh.p.k. ndaj vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Lulzim Hasballa”, në procedurën e

prokurimit objekt shyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme për operatorin ekonomik “Gentian Horieti” nuk qëndrojnë, pasi operatori ekonomik “Gentian Horieti”, i përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P., do të mbetet e kualifikuar, trajtimi i pretendimeve të ankimuesit në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Lulzim Hasballa”, nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, pasi bazuar në lëgjislicionin në fuqi për prokurimin publik, interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimuesit, nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në këtë procedurë prokurimi, pasi edhe në hipotezën që këto pretendime do të pranoheshin, ai sërish nuk do të mund të shpallej fitues i kontratës objekt prokurimi, duke qënë se në renditjen përfundimtare, para tij qëndron një tjetër operator ekonomik i kualifikuar me ofertë ekonomike në vlerë më të vogël se e ajo e operatorit ekonomik ankimues.

Në këto kushte, KPP gjykon që pretendimet e ankimuesit nuk do të merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

#### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Muça” shpk për procedurën e prokurimit “Kërkese për Propozim” me Nr. REF-78963-07-11-2018, me objekt: “Blerje materiale për lyerje dhe shërbetime të objekteve të qytetit (shkolla, kopshte, cerdhe, biblioteke etj)”, me fond limit 833,250 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 23.07.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Librazhd.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**Nr. 1441 Protokoli, Datë 28.08.2018**

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**